



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROJEKT – VENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024**

**“PËR PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT URBAN BRENDË QYTETIT,  
VËNDQËNDRIMET, TARIFËN E SHËRBIMIT DHE ORARET E FUNKSIONIMIT”.**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015. datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vcndore" neni 8, pika 2) neni 22, pika I) neni 23, pika 6) neni 29, pika 4) neni 54 gërma k), ligjin Nr.8308 date 18.03.1998 "Për transportet Rrugore", (i ndryshuar). neni 10, neni 13 dhe neni 14), Udhëzimin nr. 5627. date 18.11.2016 "Per përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brënda vëndi", të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë 2 (dy) linja të transportit publik qytetas, urban me intenerar dhe stacione si më poshtë:
  - a. **Linja 1**, Nisja nga Terminal - Rruga e Vërdoves - Varrezat e Dëshmorëve - Kisha e Re - Shkolla Koli Gusho - Rruga Rinia – Rrethrotullim i Rruges Rinia (Stacion i përbashkët me linjën 2) - Ish Agjensia (Stacion i përbashkët me linjën 2) – Terminali.
  - b. **Linja 2**. Nisja nga Terminali - Varrezat e Qytetit - Spitali - Xhamia Gorice – Lagjia Kala – Enkelana - Shkolla Gjok Shqiptari - Rruga e Spitalit – Valuta – Rrethrotullimi i Rruges Rinia (Stacion i përbashkët me linjën 1) - Ish Agjensia (Stacion i përbashkët me linjën 1) – Terminali.
2. Frekuenca e levizjes së linjave do të jetë cdo 30 min për secilën (orar fiks dhe \_\_\_\_:30 për linjën 1 dhe \_\_\_\_:15 dhe \_\_\_\_:45 për linjën 2). Shërbimi fillon në orën 07:00 deri në orën 16:00 çdo ditë të javës.
3. Të miratojë tarifat e shërbimit prej **30 (tridhjet) lek** për udhëtar pavarësisht stacioneve të hipje-zbritjes.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për licencimin e subjekteve private sipas legjislacionit në fuqi.
5. Ngarkohet Sektori i Trasnportit të bëjë mbikqyrjen e këtij shërbimi.
6. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**K R Y E T A R E**

**Manjola KAMOLLI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

Pogradec, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**RELACION PËR PROJEKT – VENDIMIN  
“PËR PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT URBAN BREnda QYTETIT,  
VËNDQËNDRIMET, TARIFËN E SHËRBIMIT DHE ORARET E FUNKSIONIMIT”.**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Projekt vendimi që paraqitet përpara jush në vijim të shqëtësimeve të ngritura nga banorët e Pogradecit dhe udhëtarët nga zonat rurale përreth për mundësinë e sigurimit të transportit brenda qytetit nga terminali dhe anasjelltas. Gjithësesi, vendosja e këtij shërbimi do ti vlejë edhe banorëve të Pogradecit apo vizitorëve për të lëvizuar në brendësi të qytetit.

Mw poshtw relacionit keni të shpjeguar me detaje linjat e propozuara, stacionet dhe frekuencën e shërbimit. Cilësojmë se dakortësimi për këto linja, vëndqëndrime dhe frekuenca është bërë pas diskutimeve me specialitetin e bashkisë për këtë qëllim.

Shkurtimisht mbi bazueshmërinë ligjore si keni të cilësuar edhe në projekt vendim përcaktohet qartë në ligjin nr. 8308 date 18.03.1998 "Për transportet Rrugore", (i ndryshuar). neni 13, neni 14 ku është sanksionuar e drejta e këshillit të bashkisë për përcaktimin e shërbimit. Gjithashtu edhe udhëzimi nr. 5627. date 18. 11.2016 "Per përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vëndi", të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, detajon edhe më tej këtë kompetencë duke përcaktuar këshillin si organin kompetent për përcaktimin e linjave qytetase, frekuencën e shërbimit.

Ndërkohë i njëjti legjislativ, konkretisht neni 10 dhe 14 i ligjit nr. 8308 date 18.03.1998 "Për transportet Rrugore", (i ndryshuar) i jep të drejtë këshillit të vendosë edhe për tarifën e këtij shërbimi. Propozimi sipas kërkuesit është për vlerën 30 lek

Cilësojmë se ky shërbim mund të shtrihet gjatë periudhës së verës për ti shërbyer vizitorëve edhe në pjesën e plazheve të cilat sot janë të pambuluara më shërbime të transportit publik.

**Të nderuar!**


Në vijim të relacionit për projekt vendimin për vendosjen e linjave të transportit urban për qytetin e Pogradecit më poshtë po ju sqarojmë me detaje mbi propozimin tonë të linjave, stacionet, oraret. Propozohen të realizohen 2 linja për shkak të shtrirjes së qytetit në dy drejtime në hyrjen nga Tirana dhe daljen nga Korça, në formë unazore, duke u munduar të prekim të gjitha pikat ekonomike dhe urbane kryesore të qytetit.



- Linja 1. Drejtimi i lëvizjes dhe stacionet;
  - o Nisja nga TERMINAL - RRUGA E VERDOVES - VARREZAT E DESHMOREVE - KISHA E RE - SHKOLLA KOLI GUSHO - RRUGA RINIA – RRETHROTULLIM I RRUGES RINIA (stacion i përbashkët me linjën 2) - ISH AGJENSIA (stacion i përbashkët me linjën 2) – TERMINALI.
  - o Gjatësia 3 km.
  - o Koha e përafërt e përshkrimit 15 minuta.



- Linja 2. Drejtimi i lëvizjes dhe stacionet;
  - o Nisja nga TERMINALI - VARREZAT E QYTETIT - SPITALI - XHAMIA GORICE – LAGJIA KALA – ENKELANA - SHKOLLA GJOK SHQIPTARI - RRUGA E SPITALIT – VALUTA – RRETHROTULLI I RRUGES RINIA (stacion i përbashkët me linjën 1) - ISH AGJENSIA (stacion i përbashkët me linjën 1) - TERMINALI.
  - o Gjatësia 4.1 km.
  - o Koha e përafërt e përshkrimit 15 minuta.



Frekuenca e lëvizjes së autobusëve do jetë çdo 30 minuta duke alternuar të dyja linjat me 15 minuta në mënyrë që nisja nga terminali të jetë çdo 15 minuta (fillon linja 1 dhe pas 15 minutash nisjet linja 2) dhe njëkohësisht stacionimi në stacionin e përbashkët ish Axsensia të bëhet çdo 15 minuta, duke ju krijuar kështu udhëtarëve lehtësi në lëvizje. Kemi pasqyrsh që stacioni tek ish Axsensia është stacioni i cili do ketë dhe fluksin më të madh të udhëtarëve.

Ndërkohë për këtë shërbim do të ishte e përshtatshme tarifa prej **30 lek/udhëtar**. Kjo tarifë është e përshtatshme në bazë të analizës dhe planit të biznesit bashkangjitur këtij relacioni. Pavarësisht se kjo tarifë në fakt është e ulët për kostot që ka ky shërbim dhe është më e ulët se gjithë qytetet në Shqipëri që ofrojnë shërbimin transporti qytetas kemi menduar se ky shërbim është në përfitim të qytetarëve dhe gjithashtu i shërben terminalit të Pogradecit si aktivitet i yni.

**Analiza e kostos së shërbimit:****PASQYRA E FITIMEVE DHE HUMBJEVE**

<b><u>INVESTIME PARASHIKIM</u></b>	<b>LEK</b>
BLERJE AUTOBUZA URBAN 2 COPE	6,000,000
<b>INVESTIME PARASHIKIM</b>	<b>6,000,000</b>

<b>SHPENZIME PARASHIKIM</b>	<b>LEK/VIT</b>
PAGA 6 PUNONJESIT (3 shoferë + 3 fatorino)	-3,200,000
SIGURIME SHOQERORE & SHENDETSORE	-550,000
KARBURANT (120 KM/DITA, HARXHIMI 30 LIT/100 KM)	-2,200,000
AMORTIZIM INVESTIMI	-1,200,000
PJESE KEMBIMI, RIPARIME, SIGURACIONE MAKINE	-1,000,000
TAKSA DHE TARIFA VENDORE	-200,000
KOSTO OPERATIVE	-850,000
<b>TOTAL SHPENZIME</b>	<b>-9,200,000</b>

<b>PASQYRA E FITIMIT</b>	<b>LEK/VIT</b>
TE ARDHURA NGA SHITJA (~800 KLIENTE / DITA)	9,500,000
SHPENZIME TOTALE	<b>-9,200,000</b>
FITIMI BRUTO	300,000
TATIM FITIMI	<b>-45,000</b>
<b>FITIMI NETO</b>	<b>255,000</b>

Si e theksuam edhe më sipër jemi të hapur të mirëpresim mendimet dhe sygjerimet tuaja si dhe cdo vërejtje.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar, ju ftojme në diskutim dhe votim.